



Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri – misioni, progresi dhe sfidat në legjislaturën e gjashtë

INDEP

INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri – misioni, progresi
dhe sfidat në legjislaturën e gjashtë**

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Përmbajtja

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në legjislaturën e V dhe roli i tij në të ardhmen	4
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	6
Tregu	7
Tregtia e Brendshme dhe e Jashtme	8
Konkurrenca dhe Masat Anti Damping dhe kundër balancuese	10
Mbrojtja e Konsumatorit dhe Siguria e Produkteve.....	11
Metrologjia	12
Investimet e huaja dhe zonat ekonomike.....	13
Zejtaria.....	14
Industria.....	14
Nafta	14
Metalet e çmuara.....	15
Ndërtimi dhe produktet e ndërtimit	16
Turizmi	17
Inspektorati dhe Mbikëqyrja e Tregut	17
Standardizimi dhe Patentat.....	18
Ministria e Infrastrukturës	19
Infrastruktura Rrugore	19
Infrastruktura hekurudhore.....	20
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	21
Energjia.....	22
Minierat dhe mineralet	23
Komunikimet elektronike shërbimi postar	24
Aviacioni Civil	25
Ndërmarrjet Publike	25
Agjencitë e pavarura nën ombrellën e Komisionit	27
Shtojcë 1 – Raporti i Komisionit Evropian dhe fushat që mbulon Komisioni	29
Lista e Figurave.....	31

Të nderuar deputete dhe deputetë të Komisionit,

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), ju uron të gjithë juve zgjedhjen si përfaqësues të popullit në legjislaturën e gjashtë. Ju jeni zgjedhur anëtarë të njërit nga komisionet me më së shumti volum të punës në Kuvendin e Kosovës. Kjo, përveç që paraqet një sfidë për ju dhe stafin administrativ, është edhe mundësi e shkëlqyer që ju të kontribuoni në shumë fusha të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, social e mjedisor të Republikës së Kosovës.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), bashkëpunon me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që nga viti 2012. Puna jonë mbështetëse dhe monitoruese, në të shumtën e rasteve gjatë këtyre viteve ka gjetur mbështetjen dhe mirëpritjen e anëtarëve të Komisionit. Duke parë përbërjen e komisionit në këtë legjislaturë, jemi të bindur që mbështetja do të vazhdojë e do të zgjerohet edhe në këtë legjislaturë.

INDEP, si institut kërkimor i fokusuar në ofrimin e zgjidhjeve politike bazuar në hulumtim të pavarur, përgjatë këtyre pesë viteve të punës me Kuvendin e Kosovës, ka hartuar afro pesëdhjetë analiza e raporte të ndryshme. Ato, i ofruan deputetëve një perspektivë të tretë e të pavarur mbi alternativat dhe dilemat e ndryshme ligjore, mbi raportet e agjencive të pavarura ose mbi zbatueshmërinë e ligjeve të caktuara. Duke qenë ndër inciuesit dhe mbështetësit e Deklaratës për Partneritet të Shoqërisë Civile me Kuvendin e Republikës së Kosovës, jemi të kënaqur që Komisioni ndër këti vite ka ndihmuar në jetësimin e këtij bashkëpunimi me OJQ-të. Jemi të bindur që këtë bashkëpunim do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Komisioni pjesë e të cilit jeni ju sot, nga perspektiva jonë do të përballet me shumë punë të rëndësishme në këtë legjislaturë. Ne nuk prisnim që të ishte legjislatura e gjashtë ajo që do ta miratonte Ligjin e ri për Eficiencën e Energjisë, ose që legjislatura e pestë do të dështonte ta çonte përpara Ligjin për Tregun e Naftës apo atë për Rezervat Shtetërore të Naftës. Në punën tuaj, sidomos nëse jeni deputetë për herë të parë, do të hasni edhe raporte të agjencive të pavarura me të cilat nuk jeni të kënaqur. Dhe kur të kërkoni të gjeni mekanizma ndëshkues për to, thjeshtë nuk do t'i gjeni në ligj, në shumicën e rasteve. Sfidat e Komisionit tuaj janë sa të mëdha aq edhe të zgjidhshme, në qoftë se për këtë ekziston vullneti dhe gatishmëria. Ne jemi gati të ndihmojmë.

Sigurisht të gjithë prej jush keni në mendje gjëra që doni të bëni si deputetë të ardhshëm të Kuvendit dhe këtij Komisioni. Megjithatë, natyrshëm, do të pyeteni se çka është bërë deri më tani. Se cila është fushëveprimtaria e Komisionit, se a është bërë ndonjë punë e mirë dhe se cilat punë kanë mbetur pa u kryer. Nëse ky dokument ju ndihmon t'i përgjigjeni këtyre pyetjeve ose një pjese të tyre, atëherë ky dokument do ta ketë realizuar qëllimin e vet. Edhe njëherë, ju urojmë për detyrën e marrë dhe shpresojmë që në fund të legjislaturës së gjashtë, të dhënat të flasin për një Komision aktiv, produktiv e mbi të gjitha, gjithëpërfshirës.

Ekipi i INDEP

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në legjislaturën e V dhe roli i tij në të ardhmen

Komisioni parlamentar që është marrë me çështje të ekonomisë, tregtisë dhe industrisë, përgjatë legjislaturave të kaluara ka modifikuar rolin dhe funksionin e tij. Deri sa në legjislaturën e parë, funksioni i Komisionit rregullohej vetëm gjerësisht me Kornizën Kushtetuese, me rregulloren e UNMIK-ut të vitit 2005, ky funksion u qartësua me Rregulloren e re të Punës dhe u krijua Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion¹. Të gjitha këto fusha i mbulon edhe Komisioni i tanishëm.

Zhvillimi ekonomik, infrastruktura, tregtia dhe industria në të gjitha legjislaturat janë karakterizuar nga një volum i madh i punës. Kjo, megjithatë, nuk ka ulur kualitetin e punës i cili është rritur në mënyrë progresive në të gjitha legjislaturat.

Nga tabela e mëposhtme vërejmë që roli i Komisionit nuk ka qenë vetëm ligjvënës dhe mbikëqyrës. Komisioni ka marrë iniciativën për të hartuar tre projektligje. Gjithashtu, janë zhvilluar aktivitete shtesë si vizita në terren, punëtori, tryeza etj. Të gjitha këto kanë rezultuar në një vendimmarrje më të lehtë brenda Komisionit.

<i>Mbledhje të mbajtura</i>	97
<i>Projektligje të procedura dhe të miratuara</i>	26
<i>Dëgjime Publike</i>	14
<i>Projektligje të kthyer në ripunim</i>	3
<i>Amendamente të hartuara</i>	1056
<i>Projektligje të hartuara nga komisioni</i>	3
<i>Monitorimi i zbatimit të ligjeve</i>	3

Figura 1 Puna e Komisionit në legjislaturën e V në numra. Burimi: Raporti fundmandator i Komisionit²

Puna e Komisionit ka qenë në rritje të vazhdueshme që nga legjislatura e parë e deri në fund të legjislaturës së pestë. Grafiku i mëposhtëm tregon për numrin e mbledhjeve të mbajtura në legjislatura të ndryshme. Edhe pse, volumi i punëve të Komisionit mund të jetë në raport të drejtë me volumin e punës së Qeverisë, prapë se prapë tendenca në rritje e mbledhjeve të mbajtura është tregues pozitiv për performancën e Komisionit.

¹ Misioni i UNMIK në Kosovë, (2005), Rregullore e Punës së Kuvendit, faqe 25, e qasshme në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Z-Rregullore%20e%20punes-shqip-20%20maj%202005-me%20ndryshime.pdf>

²Njësia mbështetëse e Komisionit, Raporti fundmandator i Komisionit për Legjislaturën e V-të.




Figura 2 Numri i mbledhjeve të mbajtura nga Komisioni në pesë legjislaturat. Burimi: Raportet zyrtare të Kuvendit për legjislatura

Numri i dëgjimeve publike është rritur konsiderueshëm. Kjo është jashtëzakonisht pozitive sepse ka mundësuar përfshirje të më shumë akterëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrje. Në legjislaturën e V, Komisioni ka instaluar një praktikë të mirë të organizimit të dëgjimeve publike për pothuaj secilën nismë ligjore, një praktikë që pritet të vazhdojë edhe në legjislaturën e ardhshme.




Figura 3 Numri i dëgjimeve publike të mbajtura nga Komisioni në pesë legjislaturat. Burimi: Raportet zyrtare të Kuvendit për legjislatura

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Një nga veçantitë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është dinamika e ndryshimeve ligjore që e kanë karakterizuar në legjislaturën e kaluar. Rregullimi i tregut, industrive kryesore në vend dhe elementeve të tjera si standardizimet, konkurrenca, inspektimi etj, janë po ashtu elemente shtesë që e bëjnë punën e kësaj ministrie mjaft voluminoze. Për dallim nga fillimi i legjislaturës së pestë, kjo legjislaturë e gjen Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me edhe një departament më shumë, atë për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka nëntë departamente:




Figura 4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamentet

Në kuadër të Ministrisë hyjnë edhe shtatë Agjenci të cilat kanë fokus/promovojnë, fusha të caktuara në kuadër të Ministrisë. Kur u konstituua legjislatura e pestë në vitin 2014, MTI kishte vetëm pesë agjenci, tanimë numri i agjencive ka arritur në shtatë.




Figura 5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjencitë

Përveç anës institucionale, baza ligjore dhe gjendja e tanishme në sektorët që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tregojnë për një legjislaturë të ngjeshur përpara në këtë fushë.

Tregu

Kosova është përcaktuar si një shtet me ekonomi të lirë të tregut sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.³ Ekonomia e lirë e tregut është përmendur edhe në nenin 7 të Kushtetutës që flet për Vlerat për të cilat shteti i Kosovës është përcaktuar. Më hollësisht, Kapitulli IX i Kushtetutës që rregullon marrëdhëniet ekonomike ka përfshirë në masë të konsiderueshme parimet e rregullimit të tregut. Edhe legjislacioni në fushën e tregut reflekton vlerat dhe përcaktimet e vendosura në Kushtetutën e vendit. Megjithatë, si demokraci e re dhe si një treg i lirë relativisht i ri, Kosova ka hasur në shumë sfida dhe probleme sa i përket rrjedhshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tipareve të ekonomisë së tregut.

Rekomandimet kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2016 sa i përket kësaj fushe kanë qenë:⁴

1. Të sigurohet që ka përafrim me legjislacionin evropian dhe të fillohet së implementuari ky legjislacion në pjesën e akreditimit, standardizimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut si dhe të amendamentohet Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 10, Ekonomia, Prishtinë.

⁴ Në fund të secilës pjesë për të cilën Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 ka përmendur sfida, do të listohen në këtë formë. Lista e plotë e sfidave nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 është vënë në Shtojcën 1.

2. Të rifuqizohen kapacitetet e Trupës Kombëtare të Standardizimit dhe të Institutit Kombëtar të Metrologjisë dhe të Trupës Kombëtare të Akreditimit.
3. Të fuqizohet mbikëqyrja e tregut dhe të përmirësohet koordinimi ndër-institucional që të sigurohet se legjislacioni është fuqizuar.

Tregtia e Brendshme dhe e Jashtme

Pjesa më e madhe e reformave në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit kanë të bëjnë me tregtinë. Asaj i është kushtuar një pjesë e veçantë e kësaj analize. Sa i përket tregtisë së brendshme dhe të jashtme, një pjesë e konsiderueshme e legjislacionit është kompletuar. Legjislatura e katërt kishte kaluar një ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tregtinë e brendshme. Ndonëse nuk përcaktonte ndryshime të mëdha në ligjin ekzistues, aty u riformuluan disa nene sikur që ishin nenet e dispozitave ndëshkuese etj.

Ligji për Markat Tregtare u miratua fillimisht në vitin 2004. Ky ligj u shfuqizua në vitin 2011 me miratimin e Ligjit të ri për Markat Tregtare i cili solli ndryshime ligjore të konsiderueshme. Nga ndryshimet në këtë ligj rrodhën edhe udhëzimet administrative të Qeverisë sikur që ishin Udhëzimi Administrativ për Regjistrimin e Markës Tregtare⁵, Udhëzimi Administrativ 01/2012, Për ekzaminimin e parakohshëm të aplikacioneve për mbrojtjen e markave tregtare, etj. Në legjislaturën e kaluar, Komisioni shqyrtoi dhe miratoi Ligjin Nr. 05/L- 040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare i cili solli ndryshime të rëndësishme që kryesisht plotësonin për afrimin me legjislacionin evropian.

Pothuaj secila legjislaturë e Kuvendit është marrë me Ligjin 2007/02-L123 për Shoqëritë Tregtare. Kur komisioni bëri ndryshim plotësimin e parë në vitin 2011, u pa që nevojiteshin ndryshime më të mëdha. Ndryshim plotësimi i këtij Ligji, rrjedhimisht kishte hyrë në edhe një cikël plotësim ndryshimi duke qenë i planifikuar qysh në programin legjislativ për vitin 2014.⁶ Komisioni pritet ta miratojë Ligjin e ri për Shoqëritë Tregtare pasi në legjislaturën që lamë pas megjithë dëgjimin publik dhe miratimin në lexim të dytë, Ligji nuk ishte miratuar në lexim të dytë për shkak të shpërndarjes së Kuvendit. Edhe pse ishte sjellë në Kuvend nga Qeveria e kaluar si ligj i ri, në programin legjislativ për vitin 2017 Qeveria ka paraparë vetëm plotësim ndryshim të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.⁷ Diskutimet për këtë Ligj janë gjithmonë të rëndësishme pasi rregullohen çështjet kryesore të ambientit të të bërit biznes në Kosovë.

⁵ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, (2012), Udhëzimi Administrativ 13/2012 për Regjistrimin e Markës Tregtare, <http://www.mti-ks.org/repository/docs/Udhezim.%20Administrativ.%20Nr.%2013-2012%20per%20regjistrimin%20e%20markes%20tregtare.pdf>

⁶ Qeveria e Kosovës, (2014), Programi Legjislativ për vitin 2014, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, faqe 9, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2014_3_ko.pdf

⁷ Qeveria e Kosovës, (2017), Programi Legjislativ për vitin 2017, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i qasshëm në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PËR_VITIN_2017_.pdf

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji Nr. 05/L-083 për FALIMENTIMIN	07.07.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12664
Ligji Nr. 2004/ 18 për Tregtinë e Brendshme	20.10.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_18_al.pdf
Ligji Nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme	08.07.2011	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20tregtin%20e%20brendshme.pdf
Ligji 2007/02-L123 për Shoqëritë Tregtare	27.05.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L123_al.pdf
Ligjit nr.02/L-123 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2007/02-18 Shoqëritë tregtare	23.06.2011	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20shoqerite%20tregtare.pdf
Ligji 2010/03-L-232 për Tregtinë e Mallrave Strategjike	09.11.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-232-alb.pdf
Ligji 2013/04-L-198 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2010/03-L-232 për Tregtinë e Mallrave Strategjike	16.08.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20tregtine%20e%20mallrave%20strategjike.pdf
Ligji 2002/6 për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë	12.05.2003	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2002_6_al.pdf
LIGJI Nr. 05/L - 040 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT Nr.04/L-026 PER MARKAT TREGTARE	24.08.2015	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11023
Ligji 2006/02-L54 për Markat Tregtare	28.06.2006	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L54_al.pdf
Ligji 2011/04-L-026 për Markat Tregtare	09.08.2011	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20markat%20tregtare.pdf

Konkurrenca dhe Masat Anti Damping dhe kundër balancuese

Baza ekzistuese ligjore:

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2004/36 për Konkurrencën	29.10.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_36_al.pdf
Ligji 2010/03-L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës	25.10.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-229-alb.pdf
Ligji 2013/04-L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-229 për mbrojtjen e konkurrencës	06.03.2014	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-226%20sh.pdf
Ligji 2010/03-L-097 për Masat Antidamping dhe Kundërbalancuese	14.04.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-097-alb.pdf
Ligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese	21.05.2014	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-240%20sh.pdf

Konkurrenca ka qenë një nga fushat më sfiduese legjislative me të cilat është përballur Kuvendi i Kosovës. Në vitin 2004, ishte miratuar Ligji për Konkurrencën. Në vitin 2010 një Ligj për Mbrojtjen e Konkurrencës është miratuar dhe i njëjti është sjellë për ndryshime në fillim të vitit 2014. Ndonëse ndryshimet ligjore janë pozitive, në praktikë ligji ka hasur në vështirësi të zbatimit. Ligji 04-L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-229 për mbrojtjen e konkurrencës ka tentuar ta rrisë efikasitetin e Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar afate më të shkurtra për marrje të vendimeve. Një element shqetësues është funksionaliteti i Autoritetit Kosovar të Kompetencës i cili është vënë në pikëpyetje në mungesë të anëtarëve të bordit gjatë viteve të kaluara. Gjithashtu, ende nuk është siguruar zbatim efektiv i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.⁸ Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe bordi i politizuar i Autoritetit të Konkurrencës janë parë gjithashtu si probleme të theksuara në këtë fushë. Që nga viti 2012 Komisioni nuk ka bërë një monitorim të zbatimit të ligjit por edhe Autoriteti i Konkurrencës përgjatë këtyre viteve nuk është se ka zhvilluar aktivitete të theksuar marrë parasysh faktin që për tre vite ishte jofunksional dhe në vazhdimësi është përballur me mungesë buxheti e hapësira të punës. Sigurimi i zbatimit të ligjit është sfida kryesore për legjislaturën e gjashtë sa i përket mbrojtjes së konkurrencës.

⁸ Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovën, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

Rekomandimet kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2016 sa i përket kësaj fushe kanë qenë:

1. Të sigurohet zbatim efektiv i Ligjit për Konkurrencën
2. Të miratohet Ligji i ri për Ndhimat Shtetërore dhe të harmonizohet legjislacioni sekondar
3. Të sigurohet operacionalizimi dhe pavarësia e Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe të përmirësohet efektshmëria e kontrollit të tij ndaj ndihmave shtetërore në të gjitha nivelet

Ligji për Masat Antidamping dhe Kundërbalancuese i vitit 2010 nuk përmbushte një pjesë të konsiderueshme të direktivave evropiane. Për këtë, Ligji Nr. 04/L-240 për Masat Antidamping dhe Kundërbalancuese barti pothuaj tërësisht Rregulloret Evropiane 597/2009 dhe 1225/2009. Megjithatë, ende nuk është bërë një monitorim i thuktë i zbatimit të këtij Ligji dhe është në shansin e legjislaturës së gjashtë që ta bëjë këtë.

Mbrojtja e Konsumatorit dhe Siguria e Produkteve

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji Nr. 2004 / 17 Për Mbrojtjen E Konsumatorëve	16 qershor 2004	http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_17_al.pdf
Ligji 2009/03-L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve	03.04.2009	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-131_al.pdf
2012/04-L-122 Ligji për mbrojtjen e konsumatorit	07.11.2012	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/121%20Ligji%20per%20mbrojtjen%20e%20konsumatorit.pdf
Ligji 2007/02-L21 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve	05.06.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L21_al.pdf
2011/04-L-078 Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve	30.12.2011	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20sigurin%20e%20pergjithshme%20te%20produkteve.pdf
2013/04-L-189 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04-L-078 për sigurinë e përgjithshme të produkteve	18.04.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20igjit%20per%20sigurine%20e%20pergjitheshme%20te%20produkteve.pdf

Kur në fund të vitit 2012, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri shqyrtoi Ligjin e ri Nr. 04/L-122 për Mbrojtjen e Konsumatorit, një mori amendamentesh u shtuan. Ndryshimet që Komisioni pati bërë me rastin miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit ishin përmendur si ndryshime pozitive edhe në Raportin e Progresit për vitin 2013. Baza ligjore është konsideruar në masë të madhe e mjaftueshme. Komisioni në këtë mandat mund të punojë më tepër në sigurimin e implementimit të këtij ligji dhe rritjes së informimit të qytetarëve rreth tij.

Ndryshimet e bëra në vitin 2013 në Ligjin Nr. 04/L-189 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve kanë qenë mjaft pozitive. Megjithatë, në të ardhmen, Komisioni duhet të luajë rol më tepër mbikëqyrës që të sigurojë që koordinimi në mes të ministrisë dhe agjencive të tjera të jetë në nivel. Mungesa e koordinimit dhe përgatitja profesionale e kuadrove kanë qenë çështje shqetësuese në të kaluarën. Gjithashtu, Komisioni mund të bashkëpunojë me trupa të tjerë parlamentarë për ndërmarrjen e një monitorimi të zbatimit të këtij ligji me qëllim të identifikimit të sfidave, ruajtjes së shëndetit publik dhe informimit publik.

Metrologjia

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji Nr. 02/L-34 për Metrologji	22.04.2006	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L34_al.pdf
Ligji Nr. 03/L-203 Për Metrologji	09.11.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-203-alb.pdf
Ligji Nr. 04/L-124 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 03/L-203 Për Metrologji	19.09.2012	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/124%20Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20metrologji.pdf

Legjislacioni për metrologji ka pësuar ndryshime që nga viti 2006 kur është miratuar Ligji për Metrologjinë. Më pas Ligji Nr. 03/L-203 ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm. Edhe ky ligj është plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2012. Komisioni duhet të monitorojë për së afërmi funksionalizimin e Agjencisë së Metrologjisë dhe po ashtu të verifikojnë kualitetin e punëve të kryera. Sa i përket legjislacionit, në rast të ndryshimeve të ardhshme, Komisioni duhet të sigurohet që shumica e standardeve teknike të vendosen në anekse të Ligjeve e jo të lihen me akt nënligjor. Kualiteti i punës së laboratorëve të Agjencisë është përmendur vazhdimisht si mangësi edhe në raportet e Komisionit Evropian.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Mungesa e pajisjeve të duhura dhe stafit të kualifikuar
2. Përafrimi me Direktivën për Instrumente Matëse duhet të kompletohet.

3. Laboratorët e matjes së kohës, frekuencës, gjatësisë dhe forcës nuk janë krejtësisht funksional për shkak të mungesës së pajisjeve dhe stafit.

Investimet e huaja dhe zonat ekonomike

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 05/L - 079 PER INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	08.02.2017	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13319
LIGJI Nr. 05/L-057 PER THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PER GARANCI KREDITORE	8.01.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11339
LIGJI Nr. 05/L-110 PER KAMATË- VONESAT NËTRANSAKSIONET TREGTARE	21.11.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13071
Ligji 2005/02-L33për Investimet e huaja.	28.04.2006	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L33_al.pdf
Ligji 2013/04-L-220 për investimet e huaja	30.12.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-220%20sh.pdf
Ligji 2009/03-L-129 për zonat ekonomike	18.05.2009	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-129_al.pdf
Ligji 2012/04-L-159 për zonat ekonomike	04.03.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20zonat%20ekonomike.pdf

Investimet e huaja janë parë si shpresa e vetme për nxitje të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Vendi ynë, përballet me rritje të vazhdueshme të deficitit tregtar dhe investimet e huaja do të rrisnin kapitalin dhe kapacitetin prodhues. Kjo do të mund të rriste eksportin dhe të zvogëlonte hendekun tregtar me të cilin përballet ekonomia jonë. Natyrshëm, investimet e huaja do të nxisnin aktivitetin ekonomik që do të rezultonte me më shumë vende të punës në sektorin privat.

Në dhjetor të vitit 2013 është miratuara Ligji për Investime të huaja duke i trajtuar si të barabartë investitorët e huaj dhe ata vendorë. Për më tepër, ky Ligj shfuqizoi Ligjin Nr. 02/L-5 për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme duke fokusuar tërësisht qëllimin tek mbështetja e investimeve të huaja. Në komentet e INDEP ndaj Ligjit për Investime të Huaja ishte përmendur vazhdimisht nevoja e trajtimit të barabartë të investitorëve vendorë me ata të huaj, madje po qe nevoja edhe duke nxjerrë një ligj të përgjithshëm për investime. Ky debat disi është shuar në legjislaturën e pestë edhe për faktin që shumë shpejt pas konstituimit u fillua të flitej për një Ligj për Investime Strategjike të cilit iu kushtua më së shumti kohë.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Zhvillimi i një strategjie për promovim të eksportit dhe një programi të përkujdesjes për investitor të huaj duhet të prioritetizohet
2. Duhet të ketë një analizë të impaktit të zonave ekonomike dhe të hendekut të funksionimit të tyre

Zejtaria

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2004/44 për Zejtari	22.07.2005	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_44_al.pdf

Zejtaria nuk ka qenë ndër prioritetet e legjislaturave të kaluara. Nuk ka pasur ndonjë përmirësim në bazën ligjore që nga viti 2004. Ligji i tanishëm nuk ofron ndonjë përkrahje ose trajtim me përparësi të zejeve në shuarje. Ka pasur ankesa të vazhdueshme të zejtarëve sidomos gjatë procesit të fiskalizimit.

Për më tepër, monitorimi i zbatimit të këtij ligji do të ishte i nevojshëm sidomos për sa i përket funksionimit të Shoqatës së Zejtarëve. Një nga pritjet është që po ashtu Komisioni të ndërmarrë masa për t'u informuar rreth incentivave të mundshme dhe atyre që do të mund të jepeshin për veprimtari të caktuara zejtare.

Industria

Industria është një nga punët më të mëdha me të cilat është përballur Komisioni në legjislaturën e kaluar. Diskutimet për ligjet që preknin industri të caktuara kanë qenë gjithnjë të pasura dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të këtyre industrive ka qenë e rregullt. Në vazhdim po përmendim disa nga industritë kryesore në vend, tek të cilat ndryshimet eventuale në legjislacion ndikojnë direkt.

Nafta

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2004/5 për Naftën dhe Produktet e Naftës	22.04.2004	http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=vi

në Kosovë		ew&id=20&Itemid=28
Ligji 2006/02-L-89 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit 2004/5 për naftë dhe derivatet e saj	05.02.2007	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L89_al.pdf

Industria e naftës është njëri nga sektorët më të ndjeshëm me të cilët është përballur puna e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Ligji i ri për Tregun e Naftës dhe Ligji për Rezervat Shtetërore të Naftës janë dy ndër projektet më të rëndësishme që do të ketë Komisioni në legjislaturën e ardhshme. Kjo bazë ligjore është veçanërisht e rëndësishme për vendosjen e sasisë së detyrueshme të rezervës shtetërore e cila është e obligueshme për Kosovën me Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Rezervat e tanishme llogariten të korrespondojnë me sasinë prej katër ditëve të konsumit. Rezervat aktuale të Kosovës në naftë nuk arrijnë më shumë sesa sasia e një jave të konsumit. Një sasi ekuivalente me sasinë e konsumit të 60 ditëve është e obligueshme sipas legjislacionit evropian. Gjithashtu, nuk është arritur ende të vendoset mbi formën e mbajtjes së rezervës shtetërore. Mbajtja e rezervës shtetërore nga një mekanizëm shtetëror do të implikonte një taksë të mirëmbajtjes, kurse mbajtja e një sasive të rezervës nga ana e tregtarëve do të kërkonte kapacitete më të mëdha inspektuese. Përkundër faktit që nuk kemi rezerva të mëdha të naftës, çmimet vazhdojnë të rriten sa herë që ato zbresin. Ulja e çmimit të naftës në nivel global nuk reflektohet gjithmonë në ulje të çmimit të naftës në tregun tonë. Sektori i naftës në Kosovë karakterizohet edhe me probleme të tjera për të cilat roli i Komisionit është i rëndësishëm. Raporti bashkëpunues i krijuar me Shoqatën e Naftarëve do të mund të shërbente edhe në zgjidhjen e problemit të fiskalizimit të pikave shitëse të naftës me të cilin është përballur Ministria e Financave.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Nuk ka progres në fushën e rezervave të detyrueshme të naftës dhe karburanteve. Rezervat e tanishme të naftës llogariten të jenë katër ditë.

Metalet e çmuara

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
2004/28 Ligji për punimet nga metalet e çmuara	24.08.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_28_al.pdf
Ligji NR. 04/L-154 për Punimet nga Metalet e Çmuara	21.01.2013	http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2869

Ligji i ri për metalet e çmuara që ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013 ka përmbushur një pjesë të mirë të kërkesave nga Bashkimi Evropian por edhe të nevojave për rregullim sa më të mirë të këtij sektori. Ligji adresoi kërkesat për krijimin e bazës ligjore për vulosje të produkteve nga metalet e çmuara, kontrollit të cilësisë së tyre dhe procedurave të inspektimit të këtyre punimeve.

Monitorimi i zbatimit të këtij ligji është njëra nga detyrat bazë të Komisionit në legjislaturën e ardhshme. Dilemat në formën e shënimit dhe të vulosjes së produkteve nga metalet e çmuara e kanë shoqëruar Komisionin gjatë vendimmarrjes me rastin e këtij ligji. Vizitat në terren janë po ashtu të një rëndësie të veçantë marrë parasysh vështirësitë në vendosjen e laboratorëve të shënimit.

Ndërtimi dhe produktet e ndërtimit

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2004/15 për ndërtimin	14.10.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_15_al.pdf
Ligji 2012/04-L-110 për Ndërtim	19.06.2012	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndertim.pdf
Ligji 2005/02-L14 për Produktet e Ndërtimit	17.05.2005	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L14_al.pdf
Ligji 2012/04-L-181 për produktet e ndërtimit	02.07.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20produktet%20e%20ndertimit.pdf
LIGJI NR. 04/L-188 Për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje	21.01.2014	http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8990

Industria e ndërtimit është po ashtu mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Në vitin 2004 ishte miratuar së pari Ligji për Ndërtim. Një ligj tjetër është miratuar në vitin 2012. Sa i përket produkteve të ndërtimit, po ashtu janë miratuar dy ligje që rregullojnë produktet e ndërtimit.

Legjislati i ndërtimit në të ardhmen pritet të avancojë në mekanizmin e ofrimit të incentivave për ndërtime të cilat ndërtohen me materiale eficiente. Po ashtu është e rëndësishme që të ketë monitorim më të madh të zbatimit të Ligjeve të ndërtimit dhe po ashtu të trajtimit të ndërtimeve pa leje.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Legjislati për të adresuar ndërtime pa leje duhet të implementohet dhe fuqizohet plotësisht
2. Nevojitet përaftrim me Rregulloren Evropiane për Ndërtime

Turizmi

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2010/03-L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike	02.03.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-168-alb.pdf
Ligji 2012/04-L-176 për turizmin	29.04.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20turizmin.pdf

Turizmi është një nga fushat në të cilat ka punuar Komisioni, sidomos me miratimin e Ligjit për Turizmin i cili ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të legjislacionit evropian. Komisioni pritet që në të ardhmen të luajë rol më tepër mbikëqyrës në mënyrë që të sigurojë zbatimin e legjislacionit sidomos sa i përket përmbushjes së obligimeve të operatorëve ndaj pakove turistike të parapara me ligj.

Komisioni pritet të luajë rol aktiv që ta mbikëqyrë zhvillimin e sektorit në përgjithësi. Në Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat të hartuar nga Ministria e Tregtisë përmendet edhe turizmi në kuptim të ofrimit të një baze sa më të mirë ligjore.⁹ Komisioni mund të luajë rol të posaçëm në monitorimin e zbatimit të ligjit qoftë përmes thirrjes së seancave dëgjimore qoftë duke e monitoruar në tërësi zbatimin e ligjit.

Inspektorati dhe Mbikëqyrja e Tregut

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 05/L-117 PER AKREDITIM	12.01.2017	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=13239
Ligji 2005/02-L1 për Inspeksionin e tregut	31.05.2005	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L1_al.pdf
Ligji 2010/03-L-181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut	09.08.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-181-alb.pdf
Ligji 2012/04-L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03-L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e	29.04.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20inspektoratin%20dhe%20mbikëqyrjen%20e%20tregut.pdf

⁹ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, (2013), Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, faqe 18, e qasshme në [http://www.mti-ks.org/repository/docs/2013_MTI_Strategjia_ZHSP_Shq_\(2\)_806808.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/2013_MTI_Strategjia_ZHSP_Shq_(2)_806808.pdf), Prishtinë.

Mbikëqyrja dhe inspektimi i tregut janë gjithnjë çështje kyçe për funksionimin e tregut në përgjithësi. Komisioni në legjislaturën e ardhshme mund të luajë rol vendimtar në përmirësimin e pakos ligjore në atë mënyrë që të ketë kompetenca qartësisht të ndara në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal. Kjo sepse deri më tani kjo ka qenë çështje që është identifikuar si më sfida. Rregullimi i kësaj çështje nga niveli qendror dhe ai lokal duhet të mos lërë vend për ngatërrim kompetencash.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Vendosja e inspektorateve të tregut edhe në nivel qendror edhe atë lokal po vazhdon të prodhojë sfida në koordinim.

Standardizimi dhe Patentat

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 04/L-029 për PATENTA	21.08.2011	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11022
LIGJI Nr. 05/L - 039 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-029 PËR PATENTA	24.08.2015	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11022
Ligji2004/12 për Standardizim	28.05.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_12_al.pdf
Ligji 2006/02-L-83për plotësim e ndryshim të ligjit nr.2004/12 për Standardizim	14.08.2006	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L83_al.pdf
Ligji2009/03-L-144 për standardizimin	19.10.2009	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-144-sh.pdf

Sa i përket standardizimit duhet patjetër të ekzistojë një mekanizëm komunikimi në mes të Komisionit dhe Agjencisë së Standardizimit. Kjo, qoftë përmes vizitave direkte, qoftë duke thirrur në seancë dëgjimore përfaqësuesit e Agjencisë. Standardizimi dhe Siguria e produkteve është një nga kërkesat në procesin integruar të Kosovës. Pas procesit të monitorimit të Ligjit Nr.03/L-144 për Standardizim, Komisioni kishte rekomanduar ndryshime dhe plotësime ose një ligj të ri në këtë fushë. Në legjislaturën e kaluar është vonuar procedimi i këtij Ligji por pritet që në legjislaturën e tanishme ky të trajtohet me prioritet.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Agjencia e Standardizimit ka mungesë të stafit dhe resurseve adekuate dhe nuk është në gjendje të implementoj plotësisht standardet evropiane.
2. Nevojitet më shumë zhvillim insitucional i Agjencisë dhe përkrahje me resurse sidomos nëse merr kompetenca të reja me ligj.
3. Nevojitet rritje e kapacitetit të trupave të konformitetit.

Ministria e Infrastrukturës

Sa i përket infrastrukturës rrugore, është Ministria e Infrastrukturës përgjegjësj kryesore për politika në këtë sektor. Ndërtimi i infrastrukturës së re të rrugëve si duket ka lënë në një mënyrë anash zhvillimin e politikave të mirëmbajtjes së rrugëve apo sigurisë në komunikacion. Investimet në autostrada të mëdha për Tiranë dhe Shkup kanë privuar fondet për mirëmbajtjen dhe vendosjen e standardeve të sigurisë për rrugët lokale.¹⁰ Megjithatë, Ministria vazhdon të investojë në rrugë dhe autostrada të reja.

Në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës veprojnë këto departamente:




Figura 6. Ministria e Infrastrukturës - Departamentet

Infrastruktura Rrugore

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 05/L-132 PER AUTOMJETE	11.05.2017	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14671
Ligji Nr. 05/L - 064	10.06.2016	https://gzk.rks-

¹⁰Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovën, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (qasur në tetor, 2017)

PER PATENTË SHOFERI		gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12516
LIGJI Nr. 05/L-088 për RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR	05.09.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12822
Ligji 2007/02-L70për sigurinë në komunikacionin rrugor	12.12.2007	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L70_al.pdf
Ligji 2003/11për Rrugët	27.06.2003	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_11_al.pdf
Ligji 2008/03-L-120për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë nr. 2003/11	30.12.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-120_al.pdf
Ligji Transporti rrugor	13.06.2013	http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8688

Siguria në Komunikacionin Rrugor ka qenë njëra nga çështjet më shqetësuese me të cilat përballet vendi ynë. Kosova në vitet në vijim duhet ta përmirësojë sigurinë në komunikacion për t'i reduktuar fatalitetet.¹¹Një element pozitiv ka qenë miratimi i pakos prej tre ligjeve në fushën e sigurisë në komunikacion, përkatësisht i Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, Ligjit Nr. 05/L - 064 për Patentë Shoferi dhe Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor. Këto ligje kanë pasur qëllim primar sigurinë në komunikacion, andaj Komisioni do të duhej të ndërmerre masa për monitorimin e zbatimit të kësaj politike relativisht të re.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Investimet në autostrada të mëdha për Tiranë dhe Shkup kanë privuar fondet për mirëmbajtjen dhe vendosjen e standardeve të sigurisë për rrugët lokale.
2. Investimet në autostrada të mëdha mund të shkaktojnë dëmtim më të shpejtë të rrugëve lokale dhe kosto më të lartë të mirëmbajtjes në të ardhmen.

Infrastruktura hekurudhore

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2008/03-L-076për Hekurudhat e Republikës së Kosovës	15.06.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L076_al.pdf

¹¹Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovën, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (qasur në tetor, 2017)

Infrastruktura hekurudhore ka nevojë të futet në prioritetet e punës legjislative të Kuvendit. Kjo pasi ky sektor ka mbetur prapa në zhvillim me gjithë potencialin ekonomik që mund të sjellë. Po ashtu nevojitet të vendoset një mekanizëm për hetimin e aksidenteve hekurudhore. Hekurudhat e Kosovës janë të prekura nga kapacitetet e dobëta të institucioneve rregulluese dhe të një gjendje të mjerë të infrastrukturës.¹²Më tepër duhet të bëhen po ashtu në takime të drejtpërdrejta me Autoritetin e Hekurudhave dhe përgjegjës të tjerë.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Si përgjegjëse për disa nga fushat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, MZHE-ja harton politikat në energji, miniera dhe minerale, ndërmarrje publike etj. Këta janë disa nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Në të kaluarën, Ministri i Zhvillimit Ekonomik ka qenë më së shpeshti i thirrur në dëgjime publike para Komisionit.

Në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik funksionojnë këto departamente:




Figura 7. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Departamentet

¹²Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovën, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (qasur në tetor, 2017)

Energjia

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji Nr. 05/L-082 për GAZIN NATYROR	13.07.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12688
Ligji Nr. 05/L - 085 për ENER GjJINË ELEKTRIKE	21.07.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744
Ligji Nr. 05/L-084 për RREGULLATORIN E ENER GjJISË	14.07.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694
Ligji Nr. 05/L-081 për ENER GjJINË	13.07.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689
Ligji Nr. 05/L -052 për ENER GjJINË TERMIKE	31.12.2015	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11326
Ligji 2004/8 për Energjinë	30.06.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_8_al.pdf
Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë	25.10.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-184-alb.pdf
Ligji 2004/10 për Energjinë Elektrike	30.06.2004	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_10_al.pdf
Ligji 2010/03-L-201 për energjinë elektrike	25.10.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-201-alb.pdf
Ligj Nr. 2004 / 9 për Rregullatorin e Energjisë	29.04.2004	http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_9_al.pdf
Ligji 2008/03-L080 për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë	15.06.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L080_al.pdf
Ligji 2010/03-L-185 për Rregullatorin e Energjisë	25.10.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-185-alb.pdf
Ligji 2009/03-L-133 për gazin natyror	12.11.2009	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-133.pdf
Ligji 2008/03-L-116 për ngrohje qendrore	13.12.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-116_al.pdf

Ligji 2011/04-L-016 për Efiçencën e Energjisë	08.07.2011	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20eficiencen%20e%20energjise.pdf
---	------------	---

Legjislacioni për Energji ka ndryshuar shpesh. Jo vetëm për rregullimin e energjisë si faktori kryesor i zhvillimit ekonomik në vend, por edhe në rregullimin e rregullatorit të energjisë dhe efiçencës së energjisë. Megjithatë me së paku 2 vite vonesë, legjislatura e kaluar ka miratuar pakon e tretë të legjislacionit në fushën e energjisë. Përveç ligjeve për energjinë, për energjinë elektrike e për gazin natyror, është miratuar edhe Ligji Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa që do t'i vë bazat për matjen e performancës energjetike në sektorin rezidencial.

Në legjislaturën e ardhshme më shumë duhet bërë në mbajtjen e Qeverisë përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve në fushën e energjisë. Ende nuk është miratuar një ligj i ri për efiçencën e energjisë që do t'i hapte rrugë krijimit të fondit për efiçencën e energjisë. Këtë mekanizëm institucional, INDEP e ka mbështetur vazhdimisht dhe përmes punës kërkimore ka ofruar edhe modele se si mund të realizohet. Gjithashtu, hapa duhen bërë në përkrahjen e projekteve për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtrishme, hapje dhe liberalizim të tregut si dhe për integrimin e operatorëve në mekanizma ndërkombëtar. Për të gjitha këto tema, Komisioni e ka mundësinë që të ngrisë tema të veçanta ose të ndërmarrë aktivitete monitoruese.

Sfidat kryesore në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016 janë:

1. Të filloj së implementuari legjislacioni evropian në fushën e sigurisë së furnizimit dhe të merret një vendim përfundimtar për kapacitetet e reja gjeneruese, për dekomisionimin e Kosovës A dhe aranzhmanet e pronësisë për Kosovën B
2. Të fuqizohen kapacitetet institucionale në tregun e energjisë, në veçanti duke siguruar pavarësinë e plotë të rregullatorit dhe stabilitetin financiar dhe duke vendosur mekanizma transparent të vendosjes së çmimeve të energjisë
3. Të bëhet ruajtja e përkohshme e deponisë së mbetjeve radioaktive në rezervarin e financuar nga EU për mbetjet e rrezikshme deri sa puna për ndërtimin e një vendqëndrimi të përhershëm vazhdon.
4. Të implementohen 'Masat reformuese të koneksionit'
5. Të implementohen aktet nënligjore për direktivën për performancën e energjisë në ndërtesa
6. Të themelohet Fondi për Efiçencën e Energjisë

Minierat dhe mineralet

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 05/L -062 PER SIGURI NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE	06.04.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12324
Ligji 2010/03-L-163 për	09.08.2010	http://www.kuvendikosoves.org/common/d

Miniera dhe Minerale		ocs/ligjet/2010-163-alb.pdf
Ligji 2012/04-L-158 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 03-L-163 Për Minierat Dhe Mineralet	18.04.2013	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20miniera%20dhe%20minerale.pdf
Ligji 2013/04-L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës	26.03.2014	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-232%20sh.pdf

Në pjesën e minierave dhe mineraleve, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka iniciuar hartimin e të dy ligjeve:¹³

- Projektligjit për Sigurinë në Punë në Veprimtarinë Minerare dhe
- Projektligjin për Miniera dhe Minerale

Projektligji për Sigurinë në Punë në Veprimtarinë Minerare arriti të miratohej dhe ka hyrë në fuqi me Nr. 05/L-062. Projektligji për Miniera dhe Minerale nuk ka arritur të miratohej përfundimisht për shkak të shpërbërjes së Kuvendit. INDEP ka mbështetur këto dy iniciativa dhe aktivitetet rreth hartimit të tyre si shumë të rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori të zhvillimit ekonomik. Në të ardhmen, Komisioni pritet që të vazhdojë të ketë rol më të madh mbikëqyrës ndaj zhvillimit të sektorit dhe në veçanti të monitorojë funksionimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

Komunikimet elektronike shërbimi postar

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI Nr. 05/L-027 PER DIXHITALIZIMIN E TRANSMETIMEVE RADIODIFUZIVE TOKESORE	24.08.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11021
Ligji 2011/04-L-109 për komunikimet elektronike	25.10.2012	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/109%20Ligji%20per%20komunikimet%20elektronike.pdf
Ligji 2005/02-L23 për shërbimet e shoqërisë informatike	08.05.2006	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L23_al.pdf
Ligji 2003/37	17.12.2003	http://www.kuvendikosoves.org/common/d

¹³ Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, (2017), Raport Fundmandator i punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, faqe 9, Prishtinë.

Fusha e Komunikimeve Elektronike dhe e Shërbimit Postar ka nevojë për përmirësime shtesë. Sa i përket shërbimit postar, pritet që Komisioni të luajë rol në shtyrjen përpara të politikave drejt liberalizimit të tregut. Procesi i dixhitalizimit gjithashtu është duke shkuar ngadalë. Komisioni i Pavarur i Medieve ka dështuar të bëjë përgatitjet për kalimin nga sistemi analog në atë dixhital.¹⁴Hapa të ngjashëm duhet të ndërmerren edhe sa i përket rritjes së konkurrencës në fushën e komunikimeve elektronike.

Aviacioni Civil

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
Ligji 2008/03-L051 për Aviacionin Civil	15.06.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L051_al.pdf
Ligji NR. 04/L-250 Për Agjencinë e Shërbimit Të Navigacionit Ajror	28.04.2014	http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9444

Në pjesën e aviacionit, më së shumti mbetet për t'u bërë në anëtarësimin e Autoritetit të Aviacionit në mekanizma ndërkombëtarë. Komisioni gjithashtu në shqyrtimet buxhetore, meqë tashmë është bërë praktikë që edhe komisionet funksionale të kenë fjalën e tyre, të mbështesë Autoritetin e Aviacionit në realizimin e projekteve pasi një pjesë e madhe e tyre nuk arrijnë të realizohen në mungesë të mjeteve. ß

Ndërmarrjet Publike

Ligji	Data e hyrjes në fuqi	Linku
LIGJI NR. 05/L -009 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE I NDRYSHUAR DHE I PLOTËSUAR MË LIGJIN NR. 04/L-111	22.05.2015	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10822
LIGJI Nr. 05/L -120 për TREPÇËN	31.09.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12988
Ligji 2008/03-L087për	15.06.2008	http://www.kuvendikosoves.org/common/d

¹⁴Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovën, i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (qasur në tetor, 2017)

Ndërmarrjet publike		ocs/ligjet/2008_03-L087_al.pdf
Ligji 2012/04-L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03-L-087 për ndërmarrjet publike	17.05.2012	http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndrysh%20e%20ligjit%20per%20ndermarrjet%20publike.pdf
LIGJI NR. 05/L-005 PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT NR. 04/L-035 PER RIORGANIZIMIN E NDERMARRJEVE TE CAKTUARA DHE PASURISE SE TYRE	29.01.2015	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10647

Në legjislaturën e pestë, Kuvendi bëri miratimin e plotësimin ndryshimit Nr. 05/L-009 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Plotësim ndryshimit nga ana e Komisionit i ka paraprirë një monitorim i zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike që është bërë nga ana e Komisionit në pjesën e dytë të vitit 2013.¹⁵ Megjithatë, Qeveria është në përgatitje të draftit të Ligjit të Ri për Ndërmarrjet Publike. Sfidat kryesore të gjetura edhe në kohën e monitorimit të Ligjit Nr. 03/L-087 kanë qenë në menaxhimin e këtyre ndërmarrjeve dhe në mungesën e llogaridhënies së bordeve ndaj institucioneve shtetërore.

Në legjislaturën e pestë, Njësia për Monitorim nuk ka dërguar në Kuvend raportet vjetore me kohë! Komisionit i është dashur të shqyrtoj raporte dy vite të vjetra!

Elementi tjetër që Ligji i ri për Ndërmarrjet Publike duhet ta specifikojë është raporti në mes të Kuvendit dhe Njësisë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Në të gjithë legjislaturën e pestë ka pasur vonesa të konsiderueshme në procedimin e Raporteve të Performancës së Ndërmarrjeve Publike. Ky është instrumenti i vetëm që Kuvendi posedon për mbikëqyrjen e performancës së ndërmarrjeve publike dhe mbajtjen në llogari të Qeverisë për kryerjen ose jo të misionit të tyre.

Me rastin e sjelljes së Projektligjit të ri për Ndërmarrjet Publike, Komisioni duhet të ketë kujdes të mos eliminohen dispozitat e pavarësisë dhe paanshmërisë së bordeve. INDEP, GAP dhe GLPS në vitin 2015 dhe 2016 denoncuan shkeljet e nenit 17.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Këto shkelje ligjore ishin bërë me rastin e emërimit të së paku 18 anëtarëve të zgjedhur të bordeve të ndërmarrjeve publike të cilët ishin të emëruar politik ose bartës paraprak të posteve të zgjedhura

¹⁵ Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, (2014), Raport Fundmandator 2011 – 2014 i punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, faqe 17, Prishtinë.

publike ose posteve të larta në parti politike. Përmes këtyre instrumenteve ligjore, INDEP, GAP dhe GLPS denoncuan rastin në Agjencinë Kundër-Korrupsionit e cila në Opinionin e saj ligjor Nr. AKK-DLK-3113/15 konfirmoi këto shkelje dhe i rekomandoi Qeverisë marrjen e masave për adresimin e shkeljeve si dhe përmirësimin e formës së konkursit publik. Pra, instrumentat ligjore që ekzistojnë në Ligjin aktual Nr. 03/1-087 për Ndërmarrjet Publike janë të domosdoshëm për luftimin e depolitizimit të mëtutjeshëm të ndërmarrjeve publike dhe si të tilla duhet fuqizuar e asesi larguar në ligjin e ri.

Agjencitë e pavarura nën ombrellën e Komisionit

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri përballet me numrin më të madh të agjencive të pavarura nën ombrellën e tij. Janë 7 Agjenci të cilat raportet e tyre vjetore i shqyrton Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri:

- Autoriteti i Aviacionit Civil
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
- Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës
- Zyra e Rregullatorit për Energji
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- Agjencia Kosovare e Privatizimit

Përveç këtyre, Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike në Republikën e Kosovës i ka dhënë të drejtën e plotë të aksionarit ndaj Operatorit të Sistemit të Transmisionit KOSTT, Kuvendit të Kosovës. Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.¹⁶ Kjo “agjenci” e re për Komisionin, do të dorëzojë një raport vjetor çdo vit deri më 30 qershor më së largu.¹⁷ Deri më tani, shqyrtimi i raporteve vjetore nga ana e agjencive të pavarura mbetet i vetmi instrument për të realizuar mbikëqyrjen parlamentare ndaj këtyre agjencive.

Meqë mekanizmi kryesor i mbikëqyrjes së Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura është raporti vjetor që dorëzohet në Kuvend, Komisioni ka bërë përpjekje që të harmonizojë formën e raportimit të këtyre agjencive. Nisma e dalë nga INDEP dhe Komisioni për hartimin e një manuali të raportimit të agjencive të pavarura ka kaluar në nivel obligues për të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit të Kosovës. Ky manual është harmonizuar dhe tani më agjencitë e pavarura raportojnë në bazë të tij.

Mandatet e anëtarëve të bordit të Agjencive të pavarura dhe forma e organizimit të tyre të brendshëm mbetet çështje e pazgjidhur deri më tani. Po ashtu, ka pasur shqetësime nga mungesa e ndarjes së kuadrove profesionale nga ata administrative. Kjo sepse është shkaktuar një pabarazi në skemën e pagave për punëtorë të agjencive të ndryshme të pavarura. Disa agjenci kanë mbetur pa

¹⁶Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike, Neni 13, faqe 28, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744> (qasur në tetor, 2017).

¹⁷Ibid.

borde në mungesë të një mekanizmi që do të detyronte Qeverinë t'i dërgonte emrat e të propozuarve në Kuvend. Duke qenë kompetencë ekskluzive, Qeveria psh. për vite të tëra nuk kishte dërguar emrat e të propozuarve për bordin e Autoritetit të Konkurrencës dhe kjo kishte shkaktuar dëme të mëdha në treg dhe në konkurrencën e lirë. INDEP ka propozuar një pako ndryshimesh ligjore me të cilën këto çështje do të adresoheshin.¹⁸ Rasti i inicimit të formës së unifikuar të raportimit të agjencive të pavarura është shpresëdhënës se Komisioni ka mundësi të inicojë ndryshime të tilla.

¹⁸Shih publikimin e INDEP “Funksionalizimi i punës së agjencive të pavarura, sfidat dhe rruga përpara” i qasshëm në <https://goo.gl/gc7Kdm>.

Shtojcë 1 – Raporti i Komisionit Evropian dhe fushat që mbulon Komisioni

Sfidat e evidentuara në Raportin e Komisionit Evropian, për fushat që mbulon Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Sfida	
Tregu	Të sigurohet që ka përaftrim me legjislacionin evropian dhe të fillohet së implementuari ky legjislacion në pjesën e akreditimit, standardizimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut si dhe të amendamentohet Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.
	Të rifuzohet kapacitetet e Trupës Kombëtare të Standardizimit dhe të Institutit Kombëtar të Metrologjisë dhe të Trupës Kombëtare të Akreditimit.
	Të fuqizohet mbikëqyrja e tregut dhe të përmirësohet koordinimi ndër-institucional që të sigurohet se legjislacioni është fuqizuar.
Konkurrenca	
	Të sigurohet zbatim efektiv i Ligjit për Konkurrencën
	Të miratohet Ligji i ri për Ndhimat Shtetërore dhe të harmonizohet legjislacioni sekondar
	Të sigurohet operacionalizimi dhe pavarësia e Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe të përmirësohet efektshmëria e kontrollit të tij ndaj ndihmave shtetërore në të gjitha nivelet
Metrologjia	
	Mungesa e pajisjeve të duhura dhe stafit të kualifikuar
	Mungesa e pajisjeve të duhura dhe stafit të kualifikuar
	Laboratorët e matjes së kohës, frekuencës, gjatësisë dhe forcës nuk janë krejtësisht funksional për shkak të mungesës së pajisjeve dhe stafit.
Investimet e huaja dhe zonat ekonomike	
	Zhvillimi i një strategjie për promovim të eksportit dhe një programi të përkujdesjes për investitor të huaj duhet të prioritizohet
	Duhet të ketë një analizë të impaktit të zonave ekonomike dhe të hendekut të funksionimit të tyre
Nafta	
	Nuk ka progres në fushën e rezervave të detyrueshme të naftës dhe karburanteve. Rezervat e tanishme të naftës llogariten të jenë

	katër ditë.
Ndërtimi dhe produktet e ndërtimit	
	Legjislacioni për të adresuar ndërtimet pa leje duhet të implementohet dhe fuqizohet plotësisht
	Nevojitet përaftrim me Rregulloren Evropiane për Ndërtime
Inspektorati dhe Mbikëqyrja e Tregut	
	Vendosja e inspektorateve të tregut edhe në nivel qendror edhe atë lokal po vazhdon të prodhojë sfida në koordinim.
Standardizimi dhe Patentat	
	Agjencia e Standardizimit ka mungesë të stafit dhe resurseve adekuate dhe nuk është në gjendje të implementoj plotësisht standardet evropiane.
	Nevojitet më shumë zhvillim insitucional i Agjencisë dhe përkrahje me resurse sidomos nëse merr kompetenca të reja me ligj.
	Nevojitet rritje e kapacitetit të trupave të konformitetit.
Infrastruktura rrugore	
	Investimet në autostrada të mëdha për Tiranë dhe Shkup kanë privuar fondet për mirëmbajtjen dhe vendosjen e standardeve të sigurisë për rrugët lokale.
	Investimet në autostrada të mëdha mund të shkaktojnë dëmtim më të shpejtë të rrugëve lokale dhe kosto më të lartë të mirëmbajtjes në të ardhmen.
Energjia	
	Të filloj së implementuari legjislacioni evropian në fushën e sigurisë së furnizimit dhe të merret një vendim përfundimtar për kapacitetet e reja gjeneruese, për dekomisionimin e Kosovës A dhe aranzhmanet e pronësisë për Kosovën B
	Të fuqizohen kapacitetet institucionale në tregun e energjisë, në veçanti duke siguruar pavarësinë e plotë të rregullatorit dhe stabilitetin financiar dhe duke vendosur mekanizma transparent të vendosjes së çmimeve të energjisë
	Të bëhet ruajtja e përkohshme e deponisë së mbetjeve radioaktive në rezervarin e financuar nga EU për mbetjet e rrezikshme deri sa puna për ndërtimin e një vendqëndrimi të përhershëm vazhdon.
	Të implementohen 'Masat reformuese të koneksionit'
	Të implementohen aktet nënligjore për direktivën për performancën e energjisë në ndërtesa

Lista e Figurave

Figura 1 Puna e Komisionit në legjislaturën e V në numra.....	4
Figura 2 Numri i mbledhjeve të mbajtura nga Komisioni në pesë legjislaturat	5
Figura 3 Numri i dëgjimeve publike të mbajtura nga Komisioni në pesë legjislaturat.....	5
Figura 4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamentet.....	6
Figura 5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Agjencitë	7
Figura 6. Ministria e Infrastrukturës - Departamentet	19
Figura 7. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Departamentet	21

“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.